



| | | | | |
|---|------------------------|--------------------------------|-------------------------------|---------------------|
| Pranimi / Dostava Priloge / Priloge Received / Delivery | 28.06 | 2021 | 1 | viti god year |
| Organ / Institucia Org. / Inst. | No. Pror. Pror. No. | Shtypja Printig Appendix | Sasia Kolicina Quantity | |
| SKIMSHICK | 3322/2021 | | 114 | |



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHTI BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.419/2021

Këshilli i Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën e datës 14.05.2021 me numër A.nr.419/2021, e parashtruar nga ankuesi i përfaqësuar nga Avokate me adresë Rruga: "Tringë Smajli", Kati i II-të, Banesa Nr.4, Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.419/2021 e datës 14.05.2021, e parashtruar nga ankuesi

II. Shfuqizohet Vendimi numër KA.nr.07/2021 i datës 20.01.2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi ka qenë i punësuar në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës sipas akt emërimit të datës 27.12.2011 me numër të referencës 03/112-274 në vendin e punës "Përkthyes shqip/serbishtë-anasjelltas", dhe me datë 20.03.2020 me numër të referencës DS-156/2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës i shuhet marrëdhënia e punës nga data 06.04.2020 për shkak të arritjes së moshës së pensionimit dhe po ashtu me këtë vendim obligohet që ankuesit ti bëhet edhe kompensimi i një (1) page mujore e njëhershme në vlerën e pagës së fundit.

Ankuesi me datë 08.01.2021 parashtron ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me pretendim ankimor se me rastin e pensionimit duke u bazuar në ligjin e punës dhe të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës sipas nenit 52 dhe 53 i takojnë dy paga mujore jubilarë si dhe dy paga përcjellëse me rastin e pensionimit. Komision për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave me datë 20.01.2021 merr vendimin me numër KA.nr.07/2021 me të cilin vendim



refuzohet si e pa bazuar ankesa e ankuesit.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datë 14.05.2021 nëpërmjet përfaqësuesit të tij Avokate [] parashtroi ankesën me numër protokollit 2397/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 19.05.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit në Gjykatën e Apelit të Kosovës. Më datë 21.05.2021, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Gjykata e Apelit të Kosovës me provat e bashkangjitura faqe 1/7.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 14.05.2021 e parashtuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi i Avokates i datës 23.12.2020; Vendimi për përfundimin e marrëdhënies së punës i datës 20.03.2020; Vendimi i datës 20.01.2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Ankesa e ankuesit e parashtuar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Konfirmimi për pranim të Vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i datës 05.05.2021; Akt emërimi i ankuesit i datës 27.12.2011; Urdhër obligimi i pagesës si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/7.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtuara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit *është e pa bazua, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se me rastin e pensionimit sipas Ligjit të Punës Nr.03/L-212 si dhe të dispozitave të nenit 52 dhe 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, i takojnë dy paga jubilarë si dhe dy paga përcjellëse me rastin e pensionimit, e i cili pretendim ankimor i ankuesit është i pabazuar, sepse për kompensimet e nëpunësve civilë janë të aplikueshme dispozitat ligjore të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe aktet tjera nënligjore për zbatimin e këtij ligji dhe në bazë të këtij ligji nëpunësve civilë me rastin e pensionimit ju takon kompensimi në vlerën e një page të njëhershme të pagës së fundit, e jo dy (2) pagave siç ankuesi pretendon, e kjo është e përcaktuar me dispozitat ligjore të nenit 22 paragrafi 2 nën paragrafin 2.2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë që nëpunësi civil ka të drejtë të kompensohet me rastin e pensionimit dhe të dispozitave të nenit 19 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, që përcakton se: **“1. Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit në Shërbimin Civil, gëzon të drejtën e kompensimit. 2. Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën prej një (1) page mujore të njëherëshme në vlerën e pagës së fundit”.**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesit se me ligjin e punës dhe Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës sipas nenit 52 dhe 53 me rastin e pensionimit i takojnë dy paga mujore jubilarë si dhe dy paga përcjellëse dhe Kolegji ka konstatuar se, Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (MPKK) e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014, ka

hyrë në fuqi me datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhe jo me shumë se tri (3) vjet, respektivisht deri me datë 31.12.2017. Kolegji po ashtu ka konstatuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e MPKK-së, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i MPKK-së, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, pas datës 31.12.2017.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në rastin e nxjerrjes së vendimit të datës 20.03.2020 me numër të referencës DS-156/2020 për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit për ankuesin _____ si dhe njohjen e kompensimit e një page pas moshës së pensionimit, për nëpunësin civil _____ është i ligjshëm dhe i drejtë sepse është marrë në bazë të dispozitave ligjore të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë si dhe Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka nxjerr Vendim për përfundimin e marrëdhënies së punës të datës 20.03.2020 me numër të referencës DS-156/2020 për shkak të arritjes së moshës së pensionimit me të cilin vendim ankuesit i njihet e drejta e një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit pas moshës së pensionimit, sipas dispozitave ligjore të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime dhe Kolegji në bazë provave të lëndës ka konstatuar se ankuesit iu është bërë pagesa në vlerë prej 485.06 Euro (katërqind e tetëdhjetë e pesë Euro e gjashtë cent) në bazë të Urdhër Obligimit për Pagesë së datës 27.05.2020 që po ashtu një gjë të tillë e ka pranuar edhe ankuesi në ankesën e parashtruar me datë 14.05.2021 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës se iu është paguar vetëm një pagë mujore në shumën e një page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me KA.nr.07/2021 të datës 20.01.2021 ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të cilat ende kanë qenë në fuqi me rastin e pensionimit të ankuesit sipas vendimit të datës 20.03.2020 me numër të referencës DS-156/2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, sepse ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse nuk ka arritur që ta vërtetoj drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, për parashtrimin e ankesës së ankuesit në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ankuesi jashtë afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës kur kemi parasysh faktin se ankuesit me datë 06.04.2020 i ka pushuar marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit dhe se i njëjti është kompensuar sipas Vendimit të datës 20.03.2020 me numër të referencës DS-156/2020 të nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës më datë 27.05.2020 sipas Urdhër Obligimit për Pagesa dhe rrjedhimisht ankuesi ka pas të drejtë që të parashtrtoj ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, pasi që i ka dal kompensimi në xhirollogarinë e tij në muajin korrik sepse ndryshimi i listës së pagave bëhet deri më datën 10 të muajit paraprak dhe se ankuesi ka pas të drejte që në afat prej

tridhjetë (30) ditësh të parashtrohet ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës lidhur me pretendimet e tij ankimore.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.419/2021

Valentina Kaçandolli BEKTESHI

Valentina Kaçandolli
Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Malsore Gashi
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokate
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Gjykatën e Apelit të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK- së.

